

**KARTAT TEKNOLOGJIKE TE PËRPUNIMIT
TE BIMEVE
AROMATIKE DHE MJEKESORE**

Tiranë 2014

Autorët:

Xhevit HYSENAJ

(Kryetar i Shoqates EPCA, Ekspert i FAO-s për BAM & Pedagog i jashtem prane UBT).

Prof. Dr. **Vath Tabaku**

Prof. Ass. Dr. **Ndoc Fasllia**

Dr. **Marsela Luarasi**

Ing. **Gjon Fierza**

Ndihmuan me eksperiencen e tyre

Pe te gjetur dhe percaktuar pergjindjet konkrete sipas bimeve qe perpunohen nga pronaret e 17 kompanive perpunuese te vendit tone, duke krijuar database-in dhe arritjen sa me afer te realitetit ne ndarjen ne % te mbetjeve teknologjike dhe produktit te gatshem te BAM-ve gjate procesit te perpunimit te BAM dhe nenprodukteve te tyre.

;

- | | |
|--------------------|------------------|
| 1. Alb | Ducros /Tepelena |
| 2. Albert | Xhaja |
| 3. Arif | Daci |
| 4. Elba Shehu shpk | |
| 5. Filip | Gjoka |
| 6. Gjergji | Qose |
| 7. Gjergji | Cibuku |
| 8. Haxhi | Berca |
| 9. Ibrahim | Myftari |
| 10. Kujtim | Keka |
| 11. Kujtim | Zere |
| 12. Mehmet | Guga |
| 13. Preng | Cupi |
| 14. Ramadan | Lika |
| 15. Tan | Koldashi |
| 16. Vasel | Muca |
| 17. Xherdo shpk | |

Miratoi: Bordi i Shoqatës EPCA.

Botimi i materialit u bë me mbështetjen financiare te **AAC-L/USAID**.

Shënim:

Manuali nuk mund të shitet, por u vihet në dispozicion për përdorim të gjithë përfaqësuesëve të industrisë së bimëve aromatike dhe mjekësore.

Literatura që u përdor:

- Standartet Shqiptare të BAM. (EPCA-s)
- Manuali teknologjik i përpunimit të BAM. (Xhevit Hysenaj)
- Të dhënat statistikore nga kompanitë e listuara më sipër.
- Manualet e makinerive qe perdoren ne linjat teknologjike.

HYRJE

Për të arritur parametrat e standarteve shqiptare të aprovuara nga Drejtoria e Standardeve Shtetërore Shqiptare të Bimëve Aromatike dhe Mjeksore, si: erëza, çajra, ekstrakte apo esenca eterovajore, ato duhet të kalojnë në proceset e përpunimit për përdorimin e tyre.

Pas më shumë se 20 vjet eksperiencë përpunim-eksportim, Industria e Bimëve Aromatike dhe Mjeksore në vendin tonë i ka të gjitha kushtet dhe kapacitetet e nevojshme të përpunimit të këtyre bimëve dhe arritjen e standarteve, në përgjigje të tregjeve botërore për përdorimin e tyre si erëza, çajra, ekstrakte apo esenca eterovajore. Kjo është arsyeja që duhet vlerësuar shumë kjo industri, për shkak se sot mbi 97% e përpunimit dhe prodhimit të esencave në vendin tonë është i destinuar për eksport.

Ndarja e Bimëve Mjeksore dhe Aromatike në 5 grupe të ndryshme si: **lule, herba, fruta, rrënjë dhe esenca**, ka për qëllim përshkrimin e faktit se secila prej tyre kalon në procese të ndryshme përpunimi dhe kërkon dhe lloje të ndryshme të linjave teknologjike sipas standarteve bashkëkohore. Kjo do të thotë se nuk është e njëjta linjë përpunimi e herbave me atë të luleve, ajo e rrënjëve me atë të frutave, pa përmendur këtu prodhimin e esencave, si një teknologji krejt tjetër. Edhe brenda grupimit ndryshon linja dhe rruga teknologjike e përpunimit, kjo në varësi të llojit të bimës, masës së përpunimit dhe faktorëve të tjerë. Kujtojmë se, këto linja janë trajtuar posaçërisht në librin **“Linjat teknologjike të përpunimit të Bimëve Aromatike Mjeksore në vendin tonë”**.

Vendi ynë ka qënë historikisht i pasur me bimë mjeksore dhe aromatike, por ka qënë i varfër në përpunimin e tyre dhe, rrjedhimisht, nuk ka patur nevojë për karta teknologjike, pasi bimët eksportoheshin ashtu siç grumbulloheshin nga vjelësit në natyrë, sepse ato ishin shumë të pastra biologjikisht po kështu edhe përsa u përket kushteve teknike të vjeljes. Por faktori kryesor i përpunimit dhe pastrimit me dorë ishte fuqia puntore e pa përfilleshme në vlerë, kështu që “favor” nuk e kishim në vendet e tjera dhe nuk e kemi dhe në sot.

Vitet e fundit, industria e Bimëve Aromatike dhe Mjeksore ka ecur përpara dhe ka marrë përsipër përpunimin e këtyre bimëve me linja të posaçme teknologjike bashkëkohore dhe eksportin e tyre me vlerën e shtuar. Por ky është vetëm fillimi, pasi kjo industri po ecën me hapa të shpejta zhvillimi.

Si rezultat i këtij përpunimi, do të ketë dhe mbetje teknologjike në përqindje të ndryshme, sipas grupeve, por edhe sipas bimëve të ndryshme. Këto karta, janë hartuar për Bimëve Aromatike dhe Mjeksore në gjëndje të thatë, pasi edhe përpunimi i tyre nuk mund të bëhet ndryshe për përdorimin në erëza apo farmaceutike, kështu përjashtohet nga kategoria e përpunimit të Bimëve Aromatike dhe Mjeksore procesi i përpunimit në esencë dhe distillateve. ..

KARTAT TEKNOLOGJIKE SIPAS GRUPEVE

Që të jemi sa më të saktë në përcaktimin e rendimentit real dhe mbetjeve përkatëse, kartat teknologjike i kemi ndarë në 5 grupe të mëdha. Këto grupe i kemi ndarë dhe specifikuar sipas emërtimeve në nëngrupe:

- **RRËNJËT**
- **HERBAT**
- **FLETET**
- **LULET**
- **FRUTA**
- **ESENCAT**

Shpjegimi i termave të përdorura

Termat, Kuptimi, Pamja.

1. Bimë Aromatike dhe Mjekësore (BAM):

Janë të gjitha ato bimë, të cilat mund të përdoren në industrinë ushqimore si erezat dhe që në organet e tyre vegetative dhe riprodhuese përmbajnë përbërës kimike (aktiv), të cilat përdoren në farmaceutikë për kurimin e sëmundjeve të ndryshme, ose në industrinë kozmetike.

2. Rrenja e Bimëve Aromatike dhe Mjekësore është kërcelli i modifikuar (transformuar) në trajtë rrënje, i cili zakonisht zhvillohet nën tokë.
3. Herba e Bimëve Aromatike Mjekësore është Bima e tërë, pa pjesën e rrënjëve.
4. Fletë e Bimëve Mjekësore, fletë të veçanta, me ose pa bisht të shkëputura nga kërcelli i bimës.
5. Lulet , janë lulet e veçanta të hapura ose gonxhe mbi 70% të hapura pa flete dhe kërcell
6. Frutat (kokrra) janë të gjitha ato fruta të egra që rriten në degët e Bimëve Aromatike Mjekësore , të pasytra dhe pa kërcellin e bimes dhe të pastruara nga lëndet e huja apo dhe lëndet e vet bimes.
7. Vaj esencial (essence), janë përzierje lëndësh të ndryshme kimike të nxjerra nga bimët aromatike me anë të distilimit ose ekstraktimit.

1. LULET

Foto 1 (do te jene disa lule te pastra dhe kercejt e tyre

KARTE TEKNOLOGJIKE

BIME MJEKESORE

1.3. „Lule Bliri e Bardhe & Kuqe“.

Flores Titliae argentea,

Flores Tiliae officinalis,

Familja: Tiliacea.

Për përpunimin cilësor të “**lule bliri i bardhe & i kuq**”, nga faza “sapo e grumbulluar” në fazën “lule e pastër” për eksport ose përdorim të brendshëm, me tregues fiziko-kimikë në përputhje me standardet shtetërore shqiptare, siç janë:

Nr	Treguesit	Standarti normal
1	Pamja:	Lulja dhe braktea të thata, të plota, me bishtin e tyre natyral. Pjesërisht të copëtuara. Gjethet në pjesën e sipërme dhe të poshtme me push me ngjyrë të gjelbër në hiri, me damarë të kuq.
2	Aroma:	Karakteristikë e vetë bimës
3	Ngjyra:	Lulja e verdhë dhe e verdhë deri në krye Braktea jeshile, jeshile në të verdhë me damarë të kuq.
4	Lagështira, jo më shumë se	13 %
5	Lule e braktea të copëtuara, që kalojnë në siten me diametër të vrimës 3 mm, jo më shumë se	5%
6	Lëndë organike të vetë bimës, jo më shumë se	1%
7	Lule pa braktea dhe braktea pa lule, jo më shumë se	7%
8	Lule të farëzuara ose krejtësisht gonxhe, jo më shumë se	10%
9	Lëndë minerale, jo më shumë se	0.25 %

duhet të kalojnë disa procese. Proceset e punës janë të thjeshta dhe pa makineri moderne, ato pastrohen me dorë si dhe kalojnë në tavolinat vibruese për largimin e lëndëve të rënda si dhe në shosha për largimin e pluhurave të ndryshme dhe atyre të vetë lëndës, që vijnë nga shkërmoqja gjatë vjeljes, tharjes dhe transportimit. Duke zbatuar procesin teknologjik të përpunimit sipas librit **„Teknologjia e Përpunimit të Bimëve Aromatike dhe Mjekësore“** si dhe duke u bazuar në eksperiencën e punës praktike të 16 kompanive përpunuese të vendit tonë si dhe analizave laboratorike të bëra në mënyrë individuale nga përpunues të ndryshëm në 20 vitet e fundit, arrijmë në konkluzionin përfundimtar se:

1. Rendimenti është 80% - 85% si produkt i standarteve.
2. Mbetjet teknologjike arrijnë në masën 15% - 20% për t'u depozituar në vendet e caktuara sipas ligjeve në fuqi.

(Kjo vlerë variabel vjen si rezultat i cilësisë së lëndës së parë, kushteve atmosferike sezonale, por dhe origjinës së grumbullimit në bazë të strukturave të tokës).

KARTE TEKNOLOGJIKE BIMË MJEKESORE

1.4 Petale te „lulekuqes“

Flores rhoeados

Papaver rhoeas L.

Familja Papaveraceae

Për përpunimin cilësor të lule “**lulekuqe**” nga faza “sapo e grumbulluar” në fazën “ lule e pastër” për eksport ose përdorim të brendshëm, me tregues fiziko-kimikë në përputhje me standardet shtetërore shqiptare, siç janë :

Nr	Treguesit	Standarti normal
1	Pamja	Petale të zhvilluara, te thata, të plota, me njolle te zeze ne fund, petalet te shkrifeta dhe pjesërisht të ngjitura. Aroma karkakteristike e vetë bimës.
2	Ngjyra	E kuqe dhe e kuqe në vishnje. Nuk lejohen të kalbura, të mykura, të nxira, insekte të gjalla ose të ngordhura dhe papastërti të ndryshme.
3	Lagështira, jo më shumë se	9
4	Petale me ngjyrë jo normale, jo më shumë se	4
5	Lëndë organike te vetë bimës, jo më shumë se	0.5
6	Lëndë minerale, jo më shumë se	0.25

duhet të kalojnë disa procese. Në përgjithësi „lulekuqja“ nuk mund të përpunohet me makineri moderne, ose më mirë të themi, nuk ka një makineri të sofistikuar për fazën e përpunimit që ne i bëjmë në vendin tonë, pasi demtohet forma e lules, por duhet të pastrohet me dorë dhe të kalojë në tavolina vibruese për ndarjen e mbetjeve të rënda, përfshirë pluhrat dhe farërat apo të tjera.

Duke zbatuar procesin teknologjik të përpunimit sipas librit „*Teknologjia e Përpunimit të Bimëve Mjekësore & Aromatike*“ si dhe duke u bazuar në eksperiencën e punës praktike të 16 kompanive përpunuese të vendit tonë si dhe analizave laboratorike të bëra në mënyrë individuale nga përpunues të ndryshëm në 20 vitet e fundit, arrijmë në konkluzionin përfundimtar se:

1-Rendimenti është 88% - 90% si produkt i standarteve,

2-Mbetjet teknologjike arrijne në masën 10% - 12% për t’u depozituar në vendet e caktuara sipas ligjeve në fuqi

(Kjo vlerë variabel vjen si rezultat i cilësisë së lëndës së parë, kushteve atmosferike sezonale por dhe origjinës së grumbullimit në bazë të strukturave të tokës).

KARTAT TEKNOLOGJIKE
BIMË ETERPVAJORE
1.5 Lule “lavandule”
Flores Lavandulae
Lavandula angustifolia MILL
Familja Labiatae

Për përpunimin cilësor të lule “**lavandule**”, nga faza “e sapo grumbulluar” në fazën “lule e pastër” për eksport ose përdorim të brendshëm me tregues fiziko-kimikë në përputhje me standardet shtetërore shqiptare, siç janë:

Nr	Treguesit	Standarti normal
1	Pamja:	Lule të çelura pjesërisht gonxhe qe shkoqen nga lastaret, me pjesë të vetë bimës.
2	Aroma:	Karakteristike e vetë bimës
3	Ngjyra:	Lule me ngjyrë blu në vjollcë deri në të kaltërt të çelur me nuanca lehtësisht gri.
4	Lagështira, jo më shumë se	10%
5	Lëndë organike të vetë bimës, jo më shumë se	3%
6	Lëndë organike të bimëve të tjera, jo më shumë se	1%
7	Lëndë minerale, jo më shumë se	1%

duhet t’i nënshtrohet disa proceseve të punës, në përputhje me kushtet e përcaktuara në librin, “**Linjat Teknologjike të Përpunimit të BAM-ve**”. Makineria shkërmoqëse (zhveshëse), është procesi i parë, pas të cilit bima bëhet gati për makineritë e tjera zinxhir të domosdoshme. Në mënyrë që të evitohen gurët dhe rëra për të mos qënë bashkëudhëtare të procesit që në momentin e parë, duhet të bëhet zhvendosja me anë të ajrit në formën e cikloneve të vogla dhe transportierëve, të cilët janë të pajisur me sita të imta, nga ku kalojnë në makineritë zik-zak. Kjo makineri është një ndër pjesët kryesore të linjës së pastrimit të bimëve e cila në parimin e punës saj ka zhvendosjen vertikale të bimëve të prera ose të shkërmoqura me anë të ajrit me presion thithës që rregullohet me anë të një rregullatori elektronik nëpërmes makinës zik-zak. Gjatë kësaj zhvendosjeje, i tërë materiali i rëndë, pra kërcenjë, gurë, materiale të tjera të ngurta, të cilat zbresin një nga një poshtë, ndërsa bimët së bashku me pluhurin, ecin në kahun e kundërt të tyre, duke u ngjitur lart dhe dërgohet në makineritë e tjera përkatëse, sipas rastit trior ose shosha të ndryshme.

Duke zbatuar procesin e përpunimit sipas librit “**Linjat Teknologjike të Përpunimit të BAM-ve**”, bazuar në eksperiencën e punës praktike te 16 kompanive perpunuese te vendit tone si dhe analizave laboratorike të bëra në mënyrë individuale nga përpunues të ndryshëm në 20 vitet e fundit, arrijmë në konkluzionin përfundimtar se:

1-Rendimenti i përpunimit të lules “lavandulë”, është 65% - 70%.

2-Pjesa tjetër prej 30 - 35%, si mbetje teknologjike, për t’u ricikluar si lëndë për prodhim esence vajore të “lavandulës”.

(Kjo vlerë variabel vjen si rezultat i cilësisë së lëndës së parë, kushteve atmosferike sezonale por dhe origjinës së grumbullimit në bazë të strukturave të tokës).

KARTE TEKNOLOGJIKE
BIMË MJEKESORE
1.5 Lule “manushaqe”
Flores Viola odoratae
Viola odorata L.
Familja Violaceae

Për përpunimin cilësor të lule “**manushaqe**” nga faza “sapo e grumbulluar” në fazën “lule e pastër” për eksport ose përdorim të brendshëm, me tregues fiziko-kimikë në përputhje me standardet shtetërore shqiptare, siç janë

Nr	Treguesit	Standarti normal
1	Pamja	Lule të zhvilluara, te celura, me bisht jo më të gjatëse 3 cm, te thata. Aroma e kendeshme, karakteristike e vetë bimës.
2	Ngjyra	Lule me ngjyre natyrale, kupa jeshile ne violete. Nuk lejohen të kalbura, të mykura, të nxira, insekte te gjalla ose te ngordhura dhe papastërti të ndryshme.
3	Lagështira, jo më shumë se	10
4	Lule me ngjyre jo normale, jo më shumë se	1
5	Lëndë organike te vetë bimës, jo më shumë se	0.5
6	Lule minerale, jo më shumë se	0.5

duhen kaluar disa procese. Ne pergjithsi lule “manushaqe” nuk mund te perpunohet me makineri moderne ose me mire te themi nuk ka nje makineri te sofistikuar per fazën e përpunimit qe ne i bejme ne vendin tone, pasi demtohet forma e lules, por duhet te pastrohet me dore dhe te kaloje ne tavolina vibruese për ndarjene e mbetjeve te renda perfshire pluhrat dhe farërat apo te tjera.

Duke zbatuar procesin teknologjik të përpunimit sipas librit “*Teknologjia e Përpunimit te Blmeve Mjekesore & Aromatike*” si dhe duke u bazuar në eksperiencën e punës praktike të 16 kompanive përpunuese të vendit tonë si dhe analizat laboratorike të bëra në mënyrë individuale nga përpunues të ndryshëm në 20 vitet e fundit, arrijmë në konkluzionin përfundimtar se:

1. Rendimenti është **80% - 85%** si produkt i standarteve,
2. Mbetjet teknologjike arrijne në masën **15% - 20%** për t’u depozituar në vendet e caktuara sipas ligjeve në fuqi.

(Kjo vlerë variabel vjen si rezultat i cilësisë së lëndës së parë, kushteve atmosferike sezonale por dhe origjinës së grumbullimit në bazë të strukturave të tokës).

KARTE TEKNOLOGJIKE
BIMË MJEKESORE
1.6 Lule „mellage“
Flores malvae silvestr
Malva silvestris L.
Familja Malvaceae

Për përpunimin cilësor të lule “**mellage**” nga faza “sapo e grumbulluar” në fazën “lule e pastër” për eksport ose përdorim të brendshëm, me tregues fiziko-kimikë në përputhje me standardet shtetërore shqiptare, siç janë:

Nr	Treguesit	Standarti normal
1	Pamja	Lile te celura se bashku me kupen e tyre, me bisht jo më të gjatëse 2 cm, te thata. Arome karakteristike te vetë bimës, me shije mulciloze.
2	Ngjyra	Lule me ngjyre manushaqe e errët, manushaqe te celur dhe kupa e gjelbër e celur. Nuk lejohen të kalbura, të mykura, të nxira, insekte të gjalla ose te ngordhura dhe papastërti të ndryshme.
3	Lagështira, jo më shumë se	12%
4	Lule me ngjyrë jo normale, jo më shumë se	3%
5	Lëndë organike te vetë bimës, jo më shumë se	3%
6	Lule qe përmbajnë ne kupe pjesërisht semundje (sucimia malvacearum), jo më shumë se	0.2%
7	Lëndë minerale, jo më shumë se	0.1%

duhen kaluar disa procese. Në përgjithësi lule “mellage” nuk mund të përpunohet me makineri moderne, ose nuk ka një makineri të sofistikuar për fazën e përpunimit që ne i bëjmë në vendin tonë, pasi dëmtohet forma e lules, por duhet të pastrohet me dorë dhe të kalojë në tavolina vibruese për ndarjen e mbetjeve të rënda, përfshirë pluhurat dhe farërat apo të tjera.

Duke zbatuar procesin teknologjik të përpunimit sipas librit “*Teknologjia e Përpunimit te Bimëve Aromatike dhe Mjekesore*” si dhe duke u bazuar në eksperiencën e punës praktike të 16 kompanive përpunuese të vendit tonë si dhe analizat laboratorike të bëra në mënyrë individuale nga përpunues të ndryshëm në 20 vitet e fundit, arrijmë në konkluzionin përfundimtar se:

1-Rendimenti është **90%-95%** si produkt i standarteve,

2-Mbetjet teknologjike arrijnë në masën **5%-10%** për t’u depozituar në vendet e caktuara sipas ligjeve në fuqi.

(Kjo vlerë variable, vjen si rezultat i cilësisë së lëndës së parë, kushteve atmosferike sezonale por dhe origjinës së grumbullimit në bazë të strukturave të tokës).

KARTE TEKNOLOGJIKE
BIMË MJEKESORE
1.7 Lule” njemijefletesh”
Flores Millefolii
Achillea millefolium L.
Familja: Compositae

Për përpunimin cilësor të lule “**njemije fletesh**” nga faza “sapo e grumbulluar” në fazën “lule e pastër” për eksport ose përdorim të brendshëm, me tregues fiziko-kimikë në përputhje me standardet shtetërore shqiptare, siç janë:

Nr	Treguesit	Standarti normal
1	Pamja	Lule të celura, të lulëzuara, por jot e farëzuara, të thata, me petale për rreth lules me bisht jo më të gjatëse 2 cm. aroma karakteristike e vetë bimës.
2	Ngjyra	Petalet të bardha dhe në qendër të verdhë të çelur. Nuk lejohen të kalbura, të mykura, të nxira, insekte të gjalla ose të ngordhura dhe papastërti të ndryshme.
3	Lagështira, jo më shumë se	13%
4	Lulet me ngjyre jo normale, jo më shumë se	2%
5	Lule me bisht 3-5 cm, jo më shumë se	10%
6	Lule me gonxhin ose të farezuara, jo më shumë se	5%
7	Lule të varieteteve të tjera mijefleteshe, jo më shumë se	2%
8	Lëndë minerale, jo më shumë se	0.5%

duhen kaluar disa procese. “Njemije fletëshi” si proces të parë ka lëvizjen me transportues me shosha të imta vibruese dhe kalimin në makineri grirëse me thika, për të kaluar pastaj në shosha të ndryshme sipas kërkesave.

Duke zbatuar procesin teknologjik të përpunimit sipas librit “*Teknologjia e Përpunimit të Bimëve Aromatike dhe Mjekësore*” si dhe duke u bazuar në eksperiencën e punës praktike të 16 kompanive përpunuese të vendit tonë si dhe analizat laboratorike të bëra në mënyrë individuale nga përpunues të ndryshëm në 20 vitet e fundit, arrijmë në konkluzionin përfundimtar se:

1. Rendimenti është 85%-90% si produkt i standarteve,

2. Mbetjet teknologjike arrijnë në masën 10%-15% për t’u depozituar në vendet e caktuara sipas ligjeve në fuqi.

(Kjo vlerë variabël vjen si rezultat i cilësisë së lëndës së parë, kushteve atmosferike sezonale por dhe origjinës së grumbullimit në bazë të strukturave të tokës).

KARTE TEKNOLOGJIKE

BIMË MJEKESORE

1.8 Lule” murrizi me flete”

Flores crataegi cum Folia

Crataegus monogyna JACQ dhe Crataegus oxacantha L.

Familja Rosaceae

Për përpunimin cilësor të lule “murrizi me flete”, nga herba në lëndë të pastër për eksport ose përdorim të brendshëm, me tregues fiziko-kimikë në përputhje me standardet shtetërore shqiptare, siç janë:

Nr	Treguesit	Standarti normal
1	Pamja	Buqeta te lulezuara, te thata, te sezonit me flete e lule të plota dhe pjesërisht te rena. Cdo buqetë duhet te permabje lule dhe pjesërisht gonxhe por jo fara me push boje hiri ose pa push, me aromë karakteristike te vetë bimës.
2	Ngjyra	Lule e bardhe dhe e bardhe ne roze. Fletet, bishtat dhe kupa e gjelbër dhe e gjelbër në të hirte. Nuk lejohen të kalbura, të mykura, të nxira, insekte te gjalla ose te ngordhura, dege te drunjezuar dhe papastërti të ndryshme.
3	Lagështira, jo më shumë se	11%
4	Buqeta me lule me ngjyre jo normale, jo më shumë se	2%
5	Lëndë organike te vetë bimës, jo më shumë se	1%
6	Fletë të prekura nga insektet jo karantinoree, jo më shumë se	1%
7	Lëndë minerale, jo më shumë se	0.1%

duhet te kalohet në disa procese pune, në përputhje me kushtet e përcaktuara në librin “Linjat Teknologjike të Përpunimit të BAM-ve”. Në mënyrë që të evitohen gurët dhe rerat për të mos qënë bashkëudhëtare të procesit që në momentin e parë, duhet të bëhet zhvendosja me anë të ajrit në formën e cilkloneve të vogla dhe transportierëve të cilët janë të pajisur me sita të imta, nga ku kalojnë në grirjen me thika dhe pastaj në zik zak. Kjo makineri është një ndër pjesët kryesore të linjës së pastrimit të bimëve e cila në parimin e punës sajë ka zhvendosjen vërtikale të bimëve të prera ose të shkërmoqura me anë të ajrit me presion thithës që rregullohet me anë të një rregullatori elektronik nëpërmes makinës zik-zak. Gjatë kësaj zhvendosjeje, i tërë materiali i rëndë, pra kërcenjë, gurë, materiale të tjera të ngurta, të cilat zbresin një nga një poshtë, ndërsa bimët së bashku me pluhurin, ecin në kahun e kundërt të tyre, duke u ngjitur lart dhe dërgohet në makinerine grirëse e me pas sipas rastit triour ose shosha të ndryshme, duke e ndarë përfundimisht produktin nga mbetjet teknologjike ne % të ndryshme.

Duke zbatuar procesin teknologjik të përpunimit sipas librit “*Teknologjia e Përpunimit të Bimëve Aromatike dhe Mjekësore*” si dhe duke u bazuar në eksperiencën e punës praktike të 16 kompanive përpunuese të vendit tonë si dhe analizat laboratorike të bëra në mënyrë individuale nga përpunues të ndryshëm në 20 vitet e fundit, arrijmë në konkluzionin përfundimtar se:

1. Rendimenti i përpunimit të rignonit të kuq herba, është **75%-80%**.

2. Pjesa tjetër prej **20-25%**, si mbetje teknologjike, do të largohet për ne vendin e depozitimit sipas ligjit.

(Kjo vlerë variabel vjen si rezultat i cilësisë së lëndës së parë, kushteve atmosferike sezonale.

KARTE TEKNOLOGJIKE BIMË MJEKESORE

1.9 BIME MJEKESORE

Lule “murrizi pa flete”

Flores *Crataegi gerebelt*

Crataegus monoyna JACQ dhe *crataegus oxycantha* L.

Familja Rosaceae

Për përpunimin cilësor të lule “murrizi pa flete”, nga faza “sapo e grumbulluar” në fazën “lule e pastër” për eksport ose përdorim të brendshëm, me tregues fiziko-kimikë në përputhje me standardet shtetërore shqiptare, siç janë:

Nr	Treguesit	Standarti normal
1	Pamja	Lule të thata, të pastra, të plota, me bishta jo më të gjatëse 1 cm, lulet të jenë pjesërisht me gonxhe pa formuar fara. Aroma dhe shija karakteristike të vetë bimës.
2	Ngjyra	Lulja e bardhe, e bardhe në krem dhe e bardhe lehtësisht në roze, kupa dhe bishti të gjelbërt me nuance në gradë he në të verdhë. Nuk lejohen të kalbura, të mykura, të nxira, insekte të gjalla ose të ngordhura dhe papastërti të ndryshme.
3	Lagështira, jo më shumë se	10%
4	Lulet me ngjyre jo normale, jo më shumë se	2%
5	Lëndë organike të vetë bimës, jo më shumë se	1%
6	Lëndë minerale, jo më shumë se	0.5%

duhen kaluar disa procese. Lule “murrizi me flete” si proces të parë ka levizjen me transportues me shosha të imta vibruese zig-zag si një ndër makineritë kryesore të linjes së përpunimit në të cilën bëhet ndarja e luleve nga fletet, të cilat mund të jenë së bashku me lulet, pas saj kalojnë në triorim për të bërë ndarjen e luleve nga kercejte e gjate apo dhe barerat që mund ta shoqërojnë lulen.

Duke zbatuar procesin teknologjik të përpunimit sipas librit “*Teknologjia e Përpunimit të Bimëve Aromatike dhe Mjekësore*” si dhe duke u bazuar në eksperiencën e punës praktike të 16 kompanive përpunuese të vendit tonë si dhe analizat laboratorike të bëra në mënyrë individuale nga përpunues të ndryshëm në 20 vitet e fundit, arrijmë në konkluzionin përfundimtar se:

1. Rendimenti është **80%-85%** si produkt i standarteve,

2. Mbetjet teknologjike arrijnë në masën 20%-15% për t’u depozituar në vendet e caktuara sipas ligjeve në fuqi.

(Kjo vlerë variabël vjen si rezultat i cilësisë së lëndës së parë, kushteve atmosferike sezonale por dhe origjinës së grumbullimit në bazë të strukturave të tokës).

KARTE TEKNOLOGJIKE BIME MJEKESORE

1.10 “Lule shtogu” Flores Sambuci gerebelt Sambucus nigra L. Familja Caprifoliaceae

Për përpunimin cilësor të lule “shtogu” nga faza “sapo e grumbulluar dhe e tharë ” në fazën “lule e pastër” për eksport ose përdorim të brendshëm, me tregues fiziko-kimikë në përputhje me standardet shtetërore shqiptare, siç janë:

Nr	Treguesit	Standarti normal
1	1. Pamja	Lule te celura, te shkoqura prej ombrelles, pa bisht, me aromë specifike te vetë bimës.
2	2. Ngjyra	Lule e verdhë dhe e verdhë e celur. Nuk lejohen të kalbura, të mykura, të nxira, dhe papastërti të ndryshme.
3	Lagështira, jo më shumë se	10%
4	Lulet me ngjyre jo normale, jo më shumë se	4%
5	Lëndë te vetë bimës 9bishta dhe kercell lulesh te copëtuara per keto jo më të gjatëse 10 mm), jo më shumë se	2%
6	Lëndë minerale, jo më shumë se	0.1%

duhen kaluar disa proçese . Lule “shtogu” si proçes te pare ka levizjen me transportues me shosha te imta vibruese per te kaluar pastaj ne zig - zag si nje nder makinerite kryesore te linjes se përpunimit në të cilen bëhet ndarja e luleve nga lëndët e renda , ne kete menyre pregatitet per ne trioret e ndarjes per te bere ndarjen e luleve nga kercejte e gjate apo dhe barerat qe mund ta shoqerojne lulen.

Duke zbatuar proçesin teknologjik të përpunimit sipas librit “*Teknologjia e Përpunimit të Bimëve Aromatike dhe Mjekesore*” si dhe duke u bazuar në eksperiencën e punës praktike të 16 kompanive përpunuese të vendit tonë si dhe analizat laboratorike të bëra në mënyrë individuale nga përpunues të ndryshëm në 20 vitet e fundit, arrijmë në konkluzionin përfundimtar se:

1.Rendimenti është **80%-90%** si produkt i standarteve,

2.Mbetjet teknologjike arrijne në masën **10%-20%** për t’u depozituar në vendet e caktuara sipas ligjeve në fuqi.

(Kjo vlerë variabel vjen si rezultat i cilësisë së lëndës së parë, kushteve atmosferike sezonale por dhe origjinës së grumbullimit në bazë të strukturave të tokës).

**KARTE TEKNOLOGJIKE
BIMË MJEKESORE**

1.11 Lule “terfil i kuq”

Flores Trifolii rubric

Trifolium pretense L.

Familja Leguminosae

Për përpunimin cilësor të lule “**terfil i kuq**” nga faza “sapo e grumbulluar dhe e thare” në fazën “lule e pastër” për eksport ose përdorim të brendshëm, me tregues fiziko-kimikë në përputhje me standardet shtetërore shqiptare, siç janë:

Nr	Treguesit	Standarti normal
1	1. Pamja	Lule të plota dhe pjesërisht të shkoqura, lulja të permabaje kupen të shoqëruar me triflete, me bisht jo më të gjatëse 1 cm, të celura normalisht (të paferzuara), të thata. Me aromë të lehte karakteristike, pa shije.
2	2. Ngjyra	Natyrore, trendafil, me nuance vjollce dhe nuance gri, në të verdhë. Nuk lejohen të kalbura, të mykura, të nxira, të farezuara, me ngjyre kafe, qime, lëndë të huaja, prania e insekteve etj.
3	Lagështira, jo më shumë se	11%
4	Lule me ngjyre jo normale, jo më shumë se	1%
5	Lule me bisht 1-3 cm, jo më shumë se	3%
6	Pluhur lulesh që kalojnë në siten me diametër 0.5 mm, jo më shumë se	1%
7	Lule të llojeve të terfileve të tjera, jo më shumë se	1%
8	Lëndë organike të vetë bimës dhe bimëve të tjera, jo më shumë se	0.5%
9	Lëndë minerale, jo më shumë se	0.5%

duhen kaluar disa procese . Lulja cilësore “terfil i kuq” si proces të parë ka levizjen me transportues me shosha të imta vibruese për të kaluar pastaj në pastrimin me dorë.

Duke zbatuar procesin teknologjik të përpunimit sipas librit “*Teknologjia e Përpunimit të Bimëve Aromatike dhe Mjekësore*” si dhe duke u bazuar në eksperiencën e punës praktike të 16 kompanive përpunuese të vendit tonë si dhe analizat laboratorike të bëra në mënyrë individuale nga përpunues të ndryshëm në 20 vitet e fundit, arrijmë në konkluzionin përfundimtar se:

1.Rendimenti është **80%-90%** si produkt i standarteve,

2.Mbetjet teknologjike arrijnë në masën **10%-20%** për t’u depozituar në vendet e caktuara sipas ligjeve në fuqi.

(Kjo vlerë variabël vjen si rezultat i cilësisë së lëndës së parë, kushteve atmosferike sezonale por dhe origjinës së grumbullimit në bazë të strukturave të tokës).

KARTE TEKNOLOGJIKE BIMË MJEKESORE

1.12 Lule „zogu“ Flores consolidate Flores Calcatrippae Delphinium consolida L. Familja Ranunculaceae

Për përpunimin cilësor të lule “zogu” nga faza “sapo e grumbulluar dhe e thare” në fazën “lule e pastër” për eksport ose përdorim të brendshëm, me tregues fiziko-kimikë në përputhje me standardet shtetërore shqiptare, siç janë:

Nr	Treguesit	Standarti normal
1	Pamja	Lule, te thata, te keputura nga kërcelli, me bishtin e tyre natyral, te perziera me ted y verietetet regalis dhe orientalis.
2	Ngjyra	Blu dhe blu ne roze. Nuk lejohen të kalbura, të mykura, të nxira, insekte te gjalla ose te ngordhura dhe papastërti të ndryshme.
3	Lagështira, jo më shumë se	10%
4	Lulet me ngjyre jo normale, jo më shumë se	5%
5	Gonxhe dhe lule te farezuara, jo më shumë se	3%
6	Lëndë organike te vetë bimës, jo më shumë se	1%
7	Lëndë minerale, jo më shumë se	0.5%

duhen kaluar disa procese punë të cilat janë te thjeshta . Ne pergjithesi lule “zogu” nuk mund te perpunohet me makineri moderne ose me mire te themi nuk ka nje makineri te sofistikuar per fazën e përpunimit qe ne i bejme ne vendin tone pasi demtohet forma e lules por duhet te pastrohet me dore dhe te kaloje ne shosha me dimensionë të ndryshme por dhe ne tavolina vibruese epr ndarjene mbetjeve te renda.

Duke zbatuar procesin teknologjik të përpunimit sipas librit *“Teknologjia e Përpunimit të Bimëve Aromatike dhe Mjekesore”* si dhe duke u bazuar në eksperiencën e punës praktike të 16 kompanive përpunuese të vendit tonë si dhe analizat laboratorike të bëra në mënyrë individuale nga përpunues të ndryshëm në 20 vitet e fundit, arrijmë në konkluzionin përfundimtar se:

- 1.Rendimenti është 85%-90%% si produkt i standarteve,
- 2.Mbetjet teknologjike arrijnë në masën 10%-15% për t’u depozituar në vendet e caktuara sipas ligjeve në fuqi.

(Kjo vlerë variabel vjen si rezultat i cilësisë së lëndës së parë, kushteve atmosferike sezonale por dhe origjinës së grumbullimit në bazë të strukturave të tokës).

2. HERBAT

Foto nr 2 me herba te pastruara dhe mbetjet e tyre

**Kartë TEKNOLOGJIKE
BIMË ETEROVAJORE**

**2.1 Bar “Borzilok i thatë”
Herba Basilisi herbs
Ocimum basilicum L.
Familja Labiatae**

Për përpunimin cilësor të barit „borzilok“ nga herba në fletë të pastër për eksport ose përdorim të brendshëm, me tregues fiziko-kimikë në përputhje me standardet shtetërore shqiptare, siç janë:

Nr	Treguesit	Standarti normal
1	1. Pamja	Herba të thata të mbushura me fletë e lule të pastra të zhvilluara të plota,
2	2. Ngjyra	Fletë të gjelbëra dhe të gjelbra të çelura
3	Lëndë organike të vetë bimës dhe bimëve të tjera por jo vajore dhe helmuese, jo më shumë se	2%
4	Lagështira, jo më shumë se	11%
5	Lëndë minerale, jo më shumë se	1%
6	Herba me ngjyrë jo normale, jo më shumë se	4%

kalohet në disa proçese pune, në përputhje me kushtet e përcaktuara në librin, “Linjat Teknologjike të Përpunimit të BAM-ve”. Makinaria shkërmoqese (zhveshëse), është proçesi i parë pas të cilit bima bëhet gati për makineritë e tjera zinxhir të domosdoshme. Në mënyrë që të evitohen gurët dhe rerat për të mos qënë bashkëudhëtare të proçesit që në momentin e parë, duhet të bëhet zhvendosja me anë të ajrit në formën e cilkloneve të vogla dhe transportierëve të cilët janë të pajisur me sita të imta, nga ku kalojnë në makineritë zik-zak. Kjo makineri është një ndër pjesët kryesore të linjës së pastrimit të bimëve e cila në parimin e punës saj ka zhvendosjen vërtikale të bimëve të prera ose të shkërmoqura me anë të ajrit me presion thithës që rregullohet me anë të një rregullatori elektronik nëpërmes makinës zik-zak. Gjatë kësaj zhvendosjeje, i tërë materiali i rëndë, pra kërcenjë, gurë, materiale të tjera të ngurta, të cilat zbresin një nga një poshtë, ndërsa bimët së bashku me pluhurin, ecin në kahun e kundërt të tyre, duke u ngjitur lart dhe dërgohet në makineritë e tjera përkatëse, sipas rastit triour ose shosha të ndryshme duke e ndarë përfundimisht produktin nga mbetjet teknologjike.

Duke zbatuar proçesin teknologjik të përpunimit sipas librit “*Teknologjia e Përpunimit të Bimëve Aromatike dhe Mjekësore*” si dhe duke u bazuar në eksperiencën e punës praktike të 16 kompanive përpunuese të vendit tonë si dhe analizat laboratorike të bëra në mënyrë individuale nga përpunues të ndryshëm në 20 vitet e fundit, arrijmë në konkluzionin përfundimtar se:

1. Rendimenti i përpunimit të borzilokut herbë, është 70%-75%,
 2. Pjesa tjetër prej 25-30%, si mbetje teknologjike, do të përdoret si lëndë e parë që do të riciklohen për prodhimin e esencës eterovajore të borzilokut herba.
- (Kjo vlerë variabel vjen si rezultat i cilësisë së lëndës së parë, kushteve atmosferike sezonale por dhe origjinës së grumbullimit në bazë të strukturave të tokës).

Kartë TEKNOLOGJIKE
BIMË ETEROVAJORE
2.2 “Borzilok i shkoqur”
Herba Basilisi gerebelt
Ocimum basilicum L.
Familja Labiatae

Për përpunimin cilësor të barit „borzilok i shkoqur“ në fazën „fletë të pastër“, për eksport ose përdorim të brendshëm, me tregues fiziko-kimikë në përputhje me standardet shtetërore shqiptare, siç janë :

Nr	Treguesit	Standarti normal
1	1. Pamja	Fletët dhe lulet të shkoqura nga kërcelli, me pamje normale Aroma dhe shija karakteristike të vetë bimës.
2	2. Ngjyra	Ngjyra e lules rozë e bardhë në krem dhe e fletëve e gjelbër e çelur ose e gjelbër me nuancë të verdha.
3	Lagështira, jo më shumë se	10%
4	Lëndë organike të vetë bimës me gjatësi 2 cm, jo më shumë se	2%
5	Lëndë minerale, jo më shumë se	0.5%
6	Pjesë me ngjyrë jo normale, jo më shumë se	2%
7	Farërat e pappjekura në bojë kafe, jo më shumë se	1%
8	Përmbajtja në hi, jo më shumë se	8%

kalohet në disa proçese pune, në përputhje me kushtet e përcaktuara në librin, “Linjat Teknologjike të Përpunimit të BAM-ve”. Në mënyrë që të evitohen gurët dhe rerat për të mos qënë bashkëudhëtare të proçesit që në momentin e parë, duhet të bëhet zhvendosja me anë të ajrit në formën e cikloneve të vogla dhe transportierëve të cilët janë të pajisura me sita të imta, nga ku kalojnë në makineritë zik-zak. Kjo makineri është një ndër pjesët kryesore të linjës së pastrimit të bimëve e cila në parimin e punës saj ka zhvendosjen vërtikale të bimëve të prera ose të shkërmoqura me anë të ajrit me presion thithës që rregullohet me anë të një rregullatori elektronik nëpërmes makinës zik-zak. Gjatë kësaj zhvendosjeje, i tërë materiali i rëndë, pra kërcenjë, gurë, materiale të tjera të ngurta, të cilat zbresin një nga një poshtë, ndërsa bimët së bashku me pluhurin, ecin në kahun e kundërt të tyre, duke u ngjitur lart dhe dërgohet në makineritë e tjera përkatëse, sipas rastit triour ose shosha të ndryshme duke e ndarë përfundimisht produktin nga mbetjet teknologjike.

Duke zbatuar proçesin teknologjik të përpunimit sipas librit “*Teknologjia e Përpunimit të Bimëve Aromatike dhe Mjekësore*” si dhe duke u bazuar në eksperiencën e punës praktike të 16 kompanive përpunuese të vendit tonë si dhe analizat laboratorike të bëra në mënyrë individuale nga përpunues të ndryshëm në 20 vitet e fundit, arrijmë në konkluzionin përfundimtar se:

1. Rendimenti i përpunimit të borzilokut të shkoqur, është 85%-90%,
2. pjesa tjetër prej 10-15% e peshës, si mbetje teknologjike, do të përdoret si lëndë e parë që do të riciklohen për prodhimin e esencës eterovajore të borzilokut të shkoqur.

(Kjo vlerë variabel vjen si rezultat i cilësisë së lëndës së parë, kushteve atmosferike sezonale por dhe origjinës së grumbullimit në bazë të strukturave të tokës).

Kartë TEKNOLOGJIKE
BIMË ETEROVAJORE
2.3 Buqet “Rozmarine”
Folia Rosmarini
Rosmarinus officinalis L.
Familja labiatae

Bima “rozmarina” buqetë cilesore për t’u përpunuar në fazën “fletë të pastër“ për eksport ose përdorim të brendshëm, me tregues fiziko-kimikë në përputhje me standardet shtetërore shqiptare, siç janë:

Nr	Treguesit	Standarti normal
1	Pamja	Fletë të zhvilluara me madhësi të ndryshme, të thataral, aroma e këndëshme specifike e vetë bimës.
2	Ngjyra	E gjelbër, e gjelbër në bojë hiri.
3	Lagështira, jo më shumë se	11%
4	Lëndë organike të vetë bimës si kërcëj dhe lule, jo më shumë se	1%
5	Lëndë minerale , jo më shumë se	0.5%
6	Fletë me ngjyrë jo notmale, jo më shumë se	1%
7	Fletë 5-6 në formë buqetashsh, jo më shumë se	30%
8	Pjesë të coptuara qe kalojnë në sitën me dimatër 3 mm, jo më shumë se	10%
9	Esencë, jo me pak se	0.1%

kalohet në disa proçese pune, në përputhje me kushtet e përcaktuara në librin, “Linjat Teknologjike të Përpunimit të BAM-ve”. Makinaria shkërmoqese (zhveshëse), është proçesi i parë pas të cilit bima bëhet gati për makineritë e tjera zinxhir të domosdoshme. Në mënyrë që të evitohen gurët dhe rerat për të mos qënë bashkëudhëtare të proçesit që në momentin e parë, duhet të bëhet zhvendosja me anë të ajrit në formën e cilkloneve të vogla dhe transportierëve të cilët janë të pajisur me sita të imta, nga ku kalojnë në makineritë zik-zak. Kjo makineri është një ndër pjesët kryesore të linjës së pastrimit të bimëve e cila në parimin e punës sajë ka zhvendosjen vërtikale të bimëve të prera ose të shkërmoqura me anë të ajrit me presion thithës që rregullohet me anë të një rregullatori elektronik nëpërmes makinës zik-zak. Gjatë kësaj zhvendosjeje, i tërë materiali i rëndë, pra kërcenjë, gurë, materiale të tjera të ngurta, të cilat zbrasin një nga një poshtë, ndërsa bimët së bashku me pluhurin, ecin në kahun e kundërt të tyre, duke u ngjitur lart dhe dërgohet në makineritë e tjera përkatëse, sipas rastit triour ose shosha të ndryshme bëhet ndarja përfundimisht e produktit te gatshem nga mbetjet teknologjike.

Duke zbatuar proçesin teknologjik të përpunimit sipas librit “*Teknologjia e Përpunimit të Bimëve Aromatike dhe Mjeksore*” si dhe duke u bazuar në eksperiencën e punës praktike të 16 kompanive përpunuese të vendit tonë si dhe analizat laboratorike të bëra në mënyrë individuale nga përpunues të ndryshëm në 20 vitet e fundit, arrijmë në konkluzionin përfundimtar se;

1. Rendimenti i përpunimit të rozmarinës buqetë, është 80%-90%,
2. Pjesa tjetër prej 10-20%, si mbetje teknologjike, do të përdoret si lëndë e parë që do të riciklohen për prodhimin e esencës eterovajore të rozmarinës.

(Kjo vlerë variabel vjen si rezultat i cilësisë së lëndës së parë, kushteve atmosferike sezonale por dhe origjinës së grumbullimit në bazë të strukturave të tokës).

Kartë TEKNOLOGJIKE
BIMË ETEROVAJORE

2.4 “Rozmarine e shkoqur”

Folia Rosmarini

Rosmarinus officinalis L.

Familja Labiatae

Bima “rozmarina e shkoqur” cilësore për t’u përpunuar në fazën “fletë të pastër” për eksport ose përdorim të brendshëm, me tregues fiziko-kimikë në përputhje me standardet shtetërore shqiptare, siç janë:

Nr	Treguesit	Standarti normal
1	Pamja	Fletë të zhvilluara me madhësi të ndryshme, të thata, të plota dhe pjesërisht të thyera, me bishtin e tyre natyral, aroma e këndëshme specifike e vetë bimës.
2	Ngjyra	E gjelbër, e gjelbër në bojë hiri. Nuk lejohen fletë të nxira, të mykura, të verdha dhe papsterti të ndryshme si pjesë drusore të bimës etj.
3	Lagështira, jo më shumë se	11%
4	Lëndë organike të vetë bimës si kërcej dhe lule, jo më shumë se	1%
5	Lëndë minerale, jo më shumë se	0.5%
6	Fletë me ngjyrë jo notmale, jo më shumë se	1%
7	Fletë 5-6 në formë buqetashsh, jo më shumë se	2%
8	Pjesë të coptuara që kalojnë në sitën me dimatër 3 mm, jo më shumë se	3%
9	Esencë, jo me pak se	0.1%

kalohet në disa procese pune, në përputhje me kushtet e përcaktuara në librin, “Linjat Teknologjike të Përpunimit të BAM-ve”. Në mënyrë që të evitohen gurët dhe rerat për të mos qënë bashkëudhëtare të procesit që në momentin e parë, duhet të bëhet zhvendosja me anë të ajrit në formën e cilkloneve të vogla dhe transportierëve të cilët janë të pajisur me sita të imta, nga ku kalojnë në makineritë zik-zak. Kjo makineri është një ndër pjesët kryesore të linjës së pastrimit të bimëve e cila në parimin e punës sajë ka zhvendosjen vertikale të bimëve të prera ose të shkërmoqura me anë të ajrit me presion thithës që rregullohet me anë të një rregullatori elektronik nëpërmes makinës zik-zak. Gjatë kësaj zhvendosjeje, i tërë materiali i rëndë, pra kërcenjë, gurë, materiale të tjera të ngurta, të cilat zbresin një nga një poshtë, ndërsa bimët së bashku me pluhurin, ecin në kahun e kundërt të tyre, duke u ngjitur lart dhe dërgohet në makineritë e tjera përkatëse, duke e ndarë përfundimisht produktin nga mbetjet teknologjike.

Duke zbatuar procesin teknologjik të përpunimit sipas librit “*Teknologjia e Përpunimit të Bimëve Aromatike dhe Mjeksore*” si dhe duke u bazuar në eksperiencën e punës praktike të 16 kompanive përpunuese të vendit tonë si dhe analizat laboratorike të bëra në mënyrë individuale nga përpunues të ndryshëm në 20 vitet e fundit, arrijmë në konkluzionin përfundimtar se:

1. Rendimenti i përpunimit të rozmarinës së shkoqur, është 60%-75%,
2. Pjesa tjetër prej 25-40%, si mbetje teknologjike, do të përdoret si lëndë e parë që do të riciklohen për prodhimin e esencës eterovajore të rozmarinës.

(Kjo vlerë variabël vjen si rezultat i cilësisë së lëndës së parë, kushteve atmosferike sezonale por dhe origjinës së grumbullimit në bazë të strukturave të tokës).

Kartë TEKNOLOGJIKE

BIMË ETEROVAJORE

2.5 “Mersine” buqetë

Folia Myrti

Myrtus communis L.

Familja Murtaceae

Për përpunimin cilësor të bimës “mersina” herba, në fazën “fletë të pastër“ për eksport ose përdorim të brendshëm, me tregues fiziko-kimikë në përputhje me standardet shtetërore shqiptare, siç janë:

Nr	Treguesit	Standarti normal
1	Pamja	Fletë të thata, të pastra, të plota dhe pjesërisht të coptuara, me bishtin e tyre natyral. Aroma dhe shija specifike e vetë bimës.
2	Ngjyra	E gjelbër, e gjelbër e çelur me nuance të verdha. Nuk lejohen fletë të kalbura, të mykura dhe papastërti të ndryshme.
3	Lagështia, jo më shumë se	10%
4	Fletë me ngjyrë jo normale, jo më shumë se	2%
5	Lënde organike të vetë bimës, jo më shumë se	1%
6	Fletë të prekura nga ndryshku (në bojë kafe), jo më shumë se	2%
7	Lëndë minerale, jo më shumë se	0,5%

kalohet në disa procese pune, në përputhje me kushtet e përcaktuara në librin, “Linjat Teknologjike të Përpunimit të BAM-ve”. Makinaria shkërmoqese (zhveshëse), është procesi i parë pas të cilit bima bëhet gati për makineritë e tjera zinxhir të domosdoshme. Në mënyrë që të evitohen gurët dhe rerat për të mos qënë bashkëudhëtare të procesit që në momentin e parë, duhet të bëhet zhvendosja me anë të ajrit në formën e cilkloneve të vogla dhe transportierëve të cilët janë të pajisur me sita të imta, nga ku kalojnë në makineritë zik-zak. Kjo makineri është një ndër pjesët kryesore të linjës së pastrimit të bimëve e cila në parimin e punës sajë ka zhvendosjen vertikale të bimëve të prera ose të shkërmoqura me anë të ajrit me presion thithës që rregullohet me anë të një rregullatori elektronik nëpërmes makinës zik-zak. Gjatë kësaj zhvendosjeje, i tërë materiali i rëndë, pra kërcenjë, gurë, materiale të tjera të ngurta, të cilat zbresin një nga një poshtë, ndërsa bimët së bashku me pluhurin, ecin në kahun e kundërt të tyre, duke u ngjitur lart dhe dërgohet në makineritë e tjera përkatëse, sipas rastit triour ose shosha të ndryshme. Pas këtij procesi, kalon në grirje me thika dhe më pas, sitja e tyre, duke i ndarë përfundimisht produktin nga mbetjet teknologjike. Duke zbatuar procesin teknologjik të përpunimit sipas librit “Teknologjia e Përpunimit të Bimëve Mjeksore & Aromatike” si dhe duke u bazuar në eksperiencën e punës praktike të 16 kompanive përpunuese të vendit tonë si dhe analizat laboratorike të bëra në mënyrë individuale nga përpunues të ndryshëm në 20 vitet e fundit, arrijmë në konkluzionin përfundimtar se:

1. Rendimenti i përpunimit të mërsinës herbë, është 50%-55%,

2. Pjesa tjetër prej 50-45%, si mbetje teknologjike, do të përdoret si lëndë e parë që do të riciklohen për prodhimin e esencës eterovajore të mersines.

(Kjo vlerë variabël vjen si rezultat i cilësisë së lëndës së parë, kushteve atmosferike sezonale por dhe origjinës së grumbullimit në bazë të strukturave të tokës).

Kartë TEKNOLOGJIKE

BIMË ETEROVAJORE

2.6 "Mersine e shkoqur"

Myrti gerebelt

Myrtus communis L.

Familja Murtaceae

Për përpunimin cilësor të bimës "mersina e shkoqur" në fazën "fletë të pastër" për eksport ose përdorim të brendshëm, cilesore, me tregues fiziko-kimikë në përputhje me standardet shtetërore shqiptare, siç janë:

Nr	Treguesit	Standarti normal
1	Pamja	Fletë të thata, të pastra, të plota dhe pjesërisht të coptuara, me bishtin e tyre natyral. Aroma dhe shija specifike e vetë bimës.
2	Ngjyra	E gjelbër, e gjelbër e çelur me nuance të verdha.
3	Lagështia, jo më shumë se	10%
4	Fletë me ngjyrë jo normale, jo më shumë se	2%
5	Lënde organike të vetë bimës, jo më shumë se	1%
6	Fletë të prekura nga ndryshku (në bojë kafe), jo më shumë se	2%
7	Lëndë minerale, jo më shumë se	0,5%

kalohet në disa proçese pune, në përputhje me kushtet e përcaktuara në librin, "Linjat Teknologjike të Përpunimit të BAM-ve". Në mënyrë që të evitohen gurët dhe rerat për të mos qënë bashkëudhëtare të proçesit që në momentin e parë, duhet të bëhet zhvendosja me transportieret të cilët janë të pajisur me sita të imta, nga ku kalojnë në makineritë zik-zak. Kjo makineri është një ndër pjesët kryesore të linjës së pastrimit të bimëve e cila në parimin e punës sajë ka zhvendosjen vërtikale të bimëve të prera ose të shkërmoqura me anë të ajrit me presion thithës që rregullohet me anë të një rregullatori elektronik nëpërmes makinës zik-zak. Gjatë kësaj zhvendosjeje, i tërë materiali i rëndë, pra kërcenjë, gurë, materiale të tjera të ngurta, të cilat zbresin një nga një poshtë, ndërsa bimët së bashku me pluhurin, ecin në kahun e kundërt të tyre, duke u ngjitur lart dhe dërgohet në makineritë e tjera përkatëse, sipas rastit triour ose shosha të ndryshme duke e ndarë përfundimisht produktin nga mbetjet teknologjike.

Duke zbatuar proçesin teknologjik të përpunimit sipas librit "*Teknologjia e Përpunimit të Bimëve Aromatike dhe Mjeksore*" si dhe duke u bazuar në eksperiencën e punës praktike të 16 kompanive përpunuese të vendit tonë si dhe analizat laboratorike të bëra në mënyrë individuale nga përpunues të ndryshëm në 20 vitet e fundit, arrijmë në konkluzionin përfundimtar se:

1. Rendimenti i përpunimit të mersinës së shkoqur, është 85%-90%, si produkt i standarteve,
2. Mbetjet teknologjike janë 15%-10% e peshës totale të futur në proçes të gatshme për t'u ricikluar dhe përdorur si lëndë e parë për prodhimin e esences eterovajore të mersinës.

(Kjo vlerë variabel vjen si rezultat i cilësisë së lëndës së parë, kushteve atmosferike sezonale por dhe origjinës së grumbullimit në bazë të strukturave të tokës).

2.7 Bar” rignon i kuq”
Herba origami vulgaris tot.
Origanum vulgare L.
Familja Labiatae

Për përpunimin cilësor të bimës “**rignon i kuq**”, nga herba në fazën “fletë të pastër “për eksport ose përdorim të brendshëm, me tregues fiziko-kimikë në përputhje me standardet shtetërore shqiptare, siç janë:

Nr	Treguesit	Standarti normal
1	Pamja	Maja gjysëm te lulezuara, te thata, te paferzuara, me gjatesi 20-30 cm.
2	Ngjyra	Fletet te gjelbëra te errata, kërcelli i gjelbër, i gjelbër në të kuqerremte, lulet roze
3	Lagështira, jo më shumë se	10%
4	Lule dhe flete qe kalojnë ne siten me diametër 3 mm , jo më shumë se	5%
5	Bar me ngjyre jo normale dhe te farezuara, jo më shumë se	5%
6	Kercell te xhveshur nga lulet dhe fletet te rena ne ballo, jo më shumë se	7%
7	Lëndë organike dhe te bimëve të tjera, jo më shumë se	1%
8	Lëndë minerale, jo më shumë se	0.1%

duhet te kalohet në disa proçese pune, në përputhje me kushtet e përcaktuara në librin, “Linjat Teknologjike të Përpunimit të BAM-ve”.Proçesi fillon me makinerin shkërmoqese (zhveshëse), pas të cilit bima bëhet gati për makineritë e tjera zinxhir të domosdoshme. Në mënyrë që të evitohen gurët dhe rerat për të mos qënë bashkëudhëtare të proçesit që në momentin e parë, duhet të bëhet zhvendosja me anë të ajrit në formën e cilkloneve të vogla dhe transportierëve të cilët janë të pajisur me sita të imta, nga ku kalojnë në makineritë zik-zak. Kjo makineri është një ndër pjesët kryesore të linjës së pastrimit të bimëve e cila në parimin e punës sajë ka zhvendosjen vërtikale të bimëve të prera ose të shkërmoqura me anë të ajrit me presion thithës që rregullohet me anë të një rregullatori elektronik nëpërmes makinës zik-zak. Gjatë kësaj zhvendosjeje, i tërë materiali i rëndë, pra kërcenjë, gurë, materiale të tjera të ngurta, të cilat zbresin një nga një poshtë, ndërsa bimët së bashku me pluhurin, ecin në kahun e kundërt të tyre, duke u ngjitur lart dhe dërgohet në makineritë e tjera përkatëse, sipas rastit triour ose shosha të ndryshme, duke e ndarë përfundimisht produktin nga mbetjet teknologjike ne perqindje të ndryshme.

Duke zbatuar proçesin teknologjik të përpunimit sipas librit “*Teknologjia e Përpunimit të Bimëve Aromatike & Mjeksore*” si dhe duke u bazuar në eksperiencën e punës praktike të 16 kompanive përpunuese të vendit tonë si dhe analizat laboratorike të bëra në mënyrë individuale nga përpunues të ndryshëm në 20 vitet e fundit, arrijmë në konkluzionin përfundimtar se:

1. Rendimenti i përpunimit të rignonit të kuq herba, është 65%-70%,
